



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.22, datë 30.04.2007

**PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.3, DATË 5.02.2007
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NË QYTETIN E TIRANËS”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 16, pika 2, 3 dhe 4, neni 32, gërma “f”, ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 14, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.3, datë 5.02.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore të caktuar me V.K.B. Nr.3, datë 5.02.2007 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, si më poshtë:
 - Për të gjitha taksat dhe tarifat vendore ku afati i pagesës së taksave vendore është caktuar 31 Mars i vitit, të ndryshohet dhe të saktësohet afati 20 Prill i çdo viti, me qëllim edhe të unifikimit me të gjitha taksat dhe tarifat e tjera vendore.
 - Subjektet tregtare të cilët janë objekt i taksës mbi pasurinë dhe i përkasin nënkategorisë II “Ndërtesa të tjera” do të përfitojnë zbritjen prej 10 % të pagesës në qoftë se paguajnë taksën deri në datën 20 Prill.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Tiranës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

SOKOL DERVISHAJ